

THUKYDHDH
EPITAFI I PERIKLIUT

ΘΟΥΚΥΔΙΔΟΥ
ΠΕΡΙΚΛΕΟΥΣ ΕΠΙΤΑΦΙΟΣ

THUCYDIDES'
PERICLES' FUNERAL ORATION

ΒΟΤΙΜΕΤ ΤΟΕΝΑ

THUKYDHDHI
EPITAFI I PERIKLIUT

ΘΟΥΚΥΔΙΔΟΥ
ΠΕΡΙΚΛΕΟΥΣ ΕΠΙΤΑΦΙΟΣ

THUCYDIDES'
PERICLES' FUNERAL ORATION

Përktheu nga greqishtja
Vangjel Dule

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2022

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike

Kopertina: Christos Papanikollaou

ISBN: 978-9928-376-21-3

© Vangjel Dule

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

PROLOG

**EPITAFI I PERIKLIUT I THUKYDHIDHIT:
MANIFEST DIAKRONIK
I DEMOKRACISË**

Thukydhidhi, i biri i Ollorus, qytetar i lirë athinas nga bashkia Alimunta, lindi në vitin 455 para Krishtit. U zgjodh në postin suprem të gjeneralit, mori pjesë në zbarkimin në Amfipoli në vitin 424 para Krishtit ku edhe dështoi. Arsyet e këtij dështimi athinasit ia atribuuan Thukydhidhit, i cili u internua përjetë dhe iu përkushtua shkrimit të veprës së tij. U rikthye në Athinë pas përfundimit të luftës së Peloponezit dhe pas nënshtrimit të Athinës ndaj Spartës, në vitin 404 para Krishtit. Vdiq në vitin 399 para Krishtit, me shumë gjasë në Thrakë.

Kur Thukydhidhi vdiq, nuk kishte arritur ende të mbaronte veprën e tij të vetme, “Historia e luftës së Peloponezit”, të cilën për rrjedhojë e plotësuan të tjerë. Thukydhidhi jetoi 20 vjet në Maqedoni, i internuar nga Athina, pa asnjë aktivitet politik, vetëm duke regjistruar ngjarjet e Luftës së Peloponezit. Ambicia e Thukydhidhit nuk ishte thjesht përshkrimi i ngjarjeve të një lufte, por edhe t’i linte trashëgimi njerëzimit një vepër me vlerë diakronike, një “pronë të

përjetshme”, duke depërtuar në kuptimin më të thellë të çështjeve të politikës.

Epitafi, Fjala e Përmortshme, ishte vendosur, më herët në Athinë, që të mbahej çdo vit për nder të të rënëve të luftës, ditën që i varrosnin solemnisht në varrezën e Qeramikos. Në një Epitaf së pari duhej t’i thurej gjerësisht lavdi të rënëve të atij viti dhe të analizohej vepra e tyre luftarake. Elementi i dytë, i domosdoshëm, ishte lavdi për të parët dhe për qytetin që rriti burra të tillë. Së fundmi, duhej të nxiteshin qytetarët më të rinj për arritje analoge dhe të ngushëlloheshin ata që kishin humbur të afërmit.

Epitafi, për ata që ranë verën e parë në Luftën e Peloponezit, mbajtur nga Perikliu, prezantohet në librin e dytë të Historisë së Thukydhidhit. Thukydhidhi në atë kohë jetonte ende në Athinë dhe për rrjedhojë ka shumë mundësi të ketë marrë pjesë në ceremoni dhe madje, duke qenë mik i ngushtë, i njohur i politikanit të madh, besohet se mori kopje të fjalës që mbajti Perikliu, me qëllim që ta përfshinte në veprën e tij.

Epitafi, sipas shumicës së studiuesve, u mbajt nga fundi i vitit 431 para Krishtit, vitit të parë të luftës, një vit që kishte sjellë invazionin e spartanëve në Atikë dhe tërheqjen e banorëve të Athinës, sipas planit të Perikliut, pas mureve të

qytetit. Thukydhidhi shënoi trazirën e madhe si edhe simpatinë e përgjithshme që mbizotëronte në të gjithë Greqinë e lirë për Spartën.

Përkthimi i klasikëve të lashtë ka traditë të gjatë. Tek Epitafi, vështirësitë në përkthim nuk qëndrojnë në ndryshimet e gjuhëve të reja nga Greqishtja e lashtë, por në gjuhën dhe sintaksën unikalisht të vështirë dhe të dendur të Thukydhidhit, si edhe në tonin panegjirik të fjalës së tij. Përkthimi, shumë nga këto vështirësi, nuk arriti t'i kapërcejë. Ndaj edhe përkthimi në gjuhën shqipe, krahasuar me origjinalin, do të lërë gjithmonë për të dëshiruar sikurse lë për të dëshiruar edhe çdo përkthim tjetër.

Fjalimi është kryesisht një analizë depërtuese në arritjet historike të sistemit demokratik, i parë jo vetëm për nga efektiviteti i tij, por edhe për nga vlera edukuese. E paraqet demokracinë si një forcë që vë në lëvizje një mori forcash të tjera më të vogla, domethënë jetën e çdo qytetari në veçanti, dhe tregon se si këto forca nga ana e tyre pasurojnë qytetin demokratik me energji të vetëdestinuara, të panjohura në sisteme të tjera.

Rezultati i parë i demokracisë që përmendet është toleranca. “Nuk indinjohemi ndaj të tjerëve për sa bëjnë për kënaqësinë e tyre, dhe as vrenjtemi në fytyrë në shenjë mospëlqimi; gjest i cili, në të

vërtetë, nuk dëmton, por gjithsesi lëndon”, - thotë Thukydhidhi, në një shprehje gjithë hire. “Por kjo liri, - shton, - kontrollohet nga një respekt i vullnetshëm për ligjet dhe veçanërisht për ligjet e pashkruara.” Demokracia, duke u hequr kufizime të parëndësishme, i bën njerëzit më të ndjeshëm ndaj parimeve të mëdha e të natyrshme të moralit. Të paktën është e sigurt se ky besim, që shpreh Perikliu në natyrën njerëzore përbën, në fund të fundit, dallimin midis Athinës dhe Spartës dhe si rrjedhojë midis demokracisë dhe oligarkisë.

Epitafi i Thukydhidhit reflekton qartë gjeniumin (Perikliun) që njohu Thukydhidhi dhe që e ndikoi thellë; një gjenialitet që karakterizohej nga njëfarë ftohtësie, madje edhe nga njëfarë zhgënjimi për mënyrën si i shikonte motivet e zakonshme njerëzore, por dhe nga një qartësi maksimale në mënyrën si i konceptonte objektivat e larta, si edhe nga një besim plot pathos për to. Fjalitë përsosmërisht të gdhendura të Epitafit mund të përmbajnë për bukuri disa nga shprehjet e vetë Perikliut, për të cilat ishte aq i famshëm. Te shkrimtarët e asaj periudhe gjejmë shumë pasazhe që përmbajnë ide analoge me ato që shprehen në Epitaf. Megjithatë, arsyeja kryesore, për të cilën pranojmë besnikërinë thelbësore, si në ton, por edhe në shprehje, është ndikimi i

thellë që kishte vetë Perikliu te historiani, i cili donte të ndriçonte më mirë ide të caktuara që përbënin filozofinë e tij politike.

Perikliu përshkruan mënyrën si i shikonin gjërat Athinasit duke përmendur dy bindje, që në thelb, janë parimet mbi të cilat mbështeten të gjitha sa kishte thënë. “Ne, - pretendon ai, - dhe nëse nuk e ndërmarrim vetë iniciativën e vendimeve të marra, të paktën gjykojmë drejt rreth masave që të tjerët propozojnë, sepse besojmë që veprat nuk i dëmton debati, por fakti që dikush që nuk sqarohet paraprakisht, përpara se të vijë ora e veprimit përmes debatit.” Se të gjithë qytetarët mund dhe duhet të marrin pjesë në politikëbërje dhe se debati i lirë publik është i domosdoshëm, këto janë sigurisht parimet bazike të demokracisë. Epitafi, pra, nxjerr në pah një arsye të madhe dhe një argumentim të lartësimit të ndritshëm të Athinës, sistemin e saj liberator. Por që nga fillimi Thukydhidhi kishte theksuar një element tjetër, po aq të rëndësishëm të suksesit të saj, vullnetin Athinas për fuqi që arrin shprehjen e tij më të plotë me fjalimin e fundit publik të Perikliut.

Në Epitaf Thukydhidhi trajton dogmën e përmendur athinase të shumëzellshtmit, duke e interpretuar si një aftësi për vullnet dhe veprim që justifikojnë gjithmonë ndryshimin. Kjo dogmë

refuzon shenjtërinë e status quo-së siç përmblihet në sloganin spartan të qetësisë. Në fjalimin e tij të fundit publik, Perikliu u drejton këtë akuzë atyre athinasve konservatorë, që do të preferonin të nënshtroheshin me qëllim që të shpëtonin pasurinë e tyre. Për Thukydhidhin ky vullnet për veprim, që identifikohet me demokracinë athinase, është pa dyshim fundamental në histori.

Perikliu, “Qytetari i parë” sipas Thukydhidhit, vdiq nga epidemia në vjeshtë të vitit 429 para Krishtit, mbi një vit pas fjalimit të tij të fundit publik që shënohet në histori. Aksioma aristokratike e të paktëve, se qytetit i ka hije ta qeverisin vetëm të virtytshmit, të shkëlqyerit (aristoi në greqisht), rigjallërohet në një demokraci, vetëm se në këtë rast virtytin nuk e përcakton origjina apo pasuria, si në aristokracitë dhe oligarkitë e mirëfillta, - “quhej demokraci, por në realitet shndërrohej në qeverisje nga qytetari i parë”, - domethënë nga politikani që qeveriste si qytetar i parë midis të tjerëve. Në kundërshtim me atë që ndodh në marrëdhëniet private, në çështjet publike, në sistemin athinas, nuk shkohet me radhë për të qeverisur, por ekziston preferenca dhe kjo preferencë shprehet me “kriter virtytin”.

Perikliu kishte katër karakteristika:

- mund të dallonte se çfarë ishte e nevojshme që të bëhej,
- mund t'ia shpjegonte këtë popullit,
- ishte patriot dhe
- i pakorruptueshëm nga paraja.

Ishte politikan me autoritet dhe aftësi të mëdha, provoi se që superior ndaj parasë, me të vërtetë i aftë të përmbante popullin, pa ia kufizuar atij lirinë. Nuk i shkonte pas popullit, por e udhëhiqte atë. Nuk përpiquej të fitonte influencë me mjete të paligjshme dhe nuk u bënte komplimente njerëzve me oratori. Kishte një autoritet kaq të madh sa që mund t'ia kundërvihej popullit dhe të provokonte zemërimin e tij. Kur e kuptonte se bashkëqytetarët e tij, nga arroganca, bëheshin përtej mase të guximshëm, në një kohë që koniunkturat nuk e lejonin, i përmbante duke i frikësuar me fjalët e tij dhe kur i shikonte të frikësuar pa arsye, u jepte kurajë. Kështu sistemi ishte në dukje demokraci, ndërkohë që e qeveriste qytetari i saj i parë.

Këto pikëpamje shprehen në të gjitha fjalimet publike të Perikliut, ndërkohë që reflektojnë vlerësimin e vetë politikanit për veten e vet, si njeri i aftë për të parë dhe shpjeguar “të duhurat”, që ishte patriot dhe superior ndaj parave. Një burrë i tillë, mendonte Thukydhidhi, do të arrinte

të ruante avantazhet e demokracisë pa lënë të manifestoheshin rreziqet e saj.

Nëse bindemi, pra, se stili i Epitafit dëshmon kryesisht stilin e vetë Perikliut, atëherë fjalimi (Epitafi) do të ketë vlerë shumë më të ndryshme sesa do të kishte në rast se do ta konsideronim stilin të rremë. Pafatësia e Athinës dhe shkaku thelbësor i shkatërrimit të saj ishte se askush nga pasuesit e tij nuk i mishëronte të gjitha këto virtyte.

Le të mjaftohemi me pasazhin e mëposhtëm nga Epitafi, ku Perikliu përshkruan dallimin midis Athinës dhe Spartës. “Kësisoj, përderisa preferojmë t’u bëjmë ballë rreziqeve, duke i marrë madje me lehtësi, e jo duke u ushtruar dhimbshëm, por edhe me burrëri të përftuar jo nga detyrimi ligjor, por nga mënyra jonë e jetesës, kemi avantazhin që, pa u ankuar para kohe, për hir të rreziqeve të ardhshme, nëse ndeshemi me to, të tregohemi po aq trima sa edhe kundërshtarët tanë, të cilët i nënshtrohen mundimit të vazhdueshëm.”

Perikliu, përmes veprës, na përcjell pamjen e qytetit të Athinës, që nga njëra anë digjet nga ndjenja kolektive dhe po kështu është i dhënë pas akteve kolektive, dhe nga ana tjetër nxit individin të kuptojë dhe të shfrytëzojë në maksimum mundësitë e tij, që është thelbësore për të kuptuar krijimet shumë të larta të epokës.

“Sepse lëvdatat, që thuhet për të tjerët, janë të pranueshme vetëm në masën që secili mendon se edhe ai vetë është i aftë për arritje të ngjashme apo analoge me ato të të lëvduarve. Çdo gjë që shkon përtej kësaj, nxit menjëherë smirën dhe mosbesimin.”

“Sepse jemi dashurues të së bukurës, por edhe njëherësh miq të thjeshtësisë, dhe kultivojmë intelektin tonë pa sakrifikuar burrërinë tonë”. Shprehja “miq të thjeshtësisë”, ka kuptimin se e bukura nuk ka lidhje me vlerën monetare dhe mund të jetë e aksesueshme për të gjithë. Fjalët, “pa sakrifikuar burrërinë” shprehin bindjen se kërkimi intelektual nuk i frenon njerëzit të veprojnë.

Qytetari i Athinës e donte shkencën, por nuk humbi vrullin që kishte për veprim, kujdesej të tejkalonte fjalët, të interesohej për shtëpinë e vet, pa qenë indiferent për çështjet publike. Qytetari i Athinës ka nevojë për debatin, sepse nuk ndjek filozofinë e të jetuarit pa telashe, domethënë të jetë i tërhequr nga rrëmuja e botës.

“Por ndërsa në marrëdhëniet tona private evitojmë sjelljen e pahijshme, në jetën tonë publike shmangim paligjshmërinë dhe, mbi të gjitha, në respekt të kërkesave të autoriteteve të radhës dhe të ligjeve, në veçanti të atyre që janë sanksionuar për mbrojtjen e të abuzuarve,

ose të atyre që, megjithëse të pashkruara, bëjnë me turp të padiskutueshëm shkelësit e tyre.” Athinasi jo vetëm që respekton atë që ka në krah, por respekton gjithashtu edhe vetveten, prandaj edhe nuk e shkel ligjin. Qytetarin e sundon një ndërgjegje e lartësuar, frika për të mos shkelur ligjin, një nënshtrim i vullnetshëm ndaj ligjit.

“Dhe se këto nuk janë vetëmburje, të imponuara nga rasti aktual, por e vërteta reale, dëshmohet pikërisht nga fuqia e qytetit, që u siguraa si rrjedhojë e cilësive tona. Sepse nga të gjitha qytetet bashkëkohore vetëm Athina, kur vihet në provë, tregohet më e lartë se fama e vet, dhe është e vetmja që as të mundurit nuk i jep shkas të indinjohet ngaqë u mund nga një armik i tillë.”

Sepse ndjenja e nderit është e vetmja gjë që nuk plaket, dhe kur vjen pleqëria e padobishme, ajo që sjell më shumë gëzim nuk është që dikush të fitojë para, siç thonë disa, por ta nderojnë.

Madje edhe armiqtë e Athinës qëndrojnë përpara mrekullisë së këtij qyteti, pa arritur ta kuptojnë, pavarësisht nëse e duan apo e urrejnë. Dhe kjo ndodh ngaqë athinasi ia doli të zotërojë absolutisht hapësirën edhe kohën nëpërmjet barazisë, meritokracisë dhe lirisë së shprehjes e të veprimit në jetën publike dhe private, të cilat karakterizonin sistemin.

Te Thukydhidhi dallojmë dukshëm ndikimet e frymës sofiste. Hedh poshtë traditën, mitin dhe çdo gjë tjetër që nuk i reziston logjikës, si ndërhyrjen e fuqive hyjnore në ecurinë e procesit social. Këto elemente mendimi radikal për epokën, të shquara tashmë te sofistët, janë të shkruara me metodën e “argumenteve kontrastuese” dhe çlirojnë mendimin e Thukydhidhit. Paralelisht me rrëfimin e luftës së Peloponezit fjala e tij takohet me universalen përmes një teorie historike të re, racionale dhe dinamike.

Shumë besojnë se Demokracia është një sistem. Demokracia nënkupton shkallë civilizimi. Ajo presupozon jo thjesht një orientim ideologjik apo drejtim të pëlqimit, por qytetari duhet të ketë përshkuar disa stadi civilizimi të brendshëm. Përkundrazi, aristokracia është nocion relativ, i lidhur ngushtë me kushtet dhe moralin lokal. Prijësit e fiseve janë një aristokraci. Demokracia nuk njih prijës fisesh dhe kjo sigurisht është e rrezikshme, sepse mund të lëkundë nocionin e hierarkisë natyrale kur disiplina nuk është e brendshme, domethënë kur individët nuk kanë arritur në atë stad civilizimi ku qytetari u përmbahet ideve të përgjithshme të padeforuara në fobi.

Në shekullin e 20-të, Eleftherios Venizellos theksoi se teksti historik i Thukydhidhit është

madje edhe sot në gjendje t'u japë përgjigje të gjitha problemeve që u shfaqen protagonistëve të jetës politike. Për tkurrjen e virtytit demokratik, që jetojmë sot, kurrë nuk kanë përgjegjësi të gjithë, por në çdo rast duhet t'i drejtojmë vetes pyetjen nëse matura e popujve lë diçka për të dëshiruar.

Çdolloj shqetësimi sot e quajmë “agoni”: edhe stresin e neurotikut, edhe ndjenjën e pasigurisë së frikacakut, edhe tmerrin e konservatorit për kolapsin e mirëqenies së tij, edhe padurimin grabitës të aventurierit, edhe pangopësinë e grykësit, edhe marrjen e frymës së arrivistit të ulët apo të hedonistit vulgar që përpiqet të sigurojë të mirat që ofron teknokracia. Nëse do të arrinim ta pastronim temën e “agonisë” nga gjithë këto keqkuptime, pak veta do të gjenin veten e tyre në të. Sepse mendimtarët gjithmonë kanë prirjen të përgjithësojnë. Atë që vetëm disa ndërgjegje, veçanërisht të ndjeshme apo pioniere e kapin në ajër, besojnë se e nuhasin edhe të gjithë sa nuk e disponojnë mendimin depërtues, të ashtuquajturin shikim të dytë, aq mundues, që e kanë vizionarët.

“Leadership nuk do të thotë vetëm teknikë”, thotë Angelos Terzakis. Do të thotë edhe përmbajtje ideologjike, që shërbehet nga teknika, parime që udhëheqin, frymëzojnë. Domethënë, do të thotë besim që përcakton një qëllim.

Përndryshe teknika e lidërshiptit shndërrohet në një kontraktor që kryen punë të vogla. Nëse ai nuk jua bën mirë punën tuaj, atëherë e ndryshoni, merrni kontraktor tjetër. Druhem se jetojmë në një epokë që ka mbivlerësuar naivitetin e popujve dhe inteligjencën e liderëve të botës.

Sistemi demokratik është i mundshëm aty ku të gjitha gjenden në masën e njeriut, ku individi ka personalitet dhe nuk transformohet në një njësi impersonale mes një morie astronomike.

Siç shkroi, gjithashtu, Aristovoulos Manesis në librin e tij me titull “E Drejta Kushtetuese si teknikë e lirisë politike” (“Το Συνταγματικό Δίκαιο ως τεχνική τής πολιτικής ελευθερίας”), në sistemin demokratik ka qytetarë me qëndrim të ndryshëm social dhe me mundësi të pabarabarta ekonomike. Demokracia sociale bëhet esenciale vetëm nëse barazia dhe liria shtrihen dhe zgjerohen përtej sferës së pastër ligjore-politike edhe në atë ekonomike dhe shoqërore. Të njëjtat na mëson edhe Epitafi i Perikliut. Promovimi i zbatimit efektiv të parimit demokratik duhet ndërthurur me demokracinë politike. Në procesin historik çështja e demokracisë politike dhe sociale nuk shtrohet në mënyrë alternative, por kumulative.

Alekos Papadhopoulos
ish-ministër i Financës të Greqisë

THUKYDHDHI
EPITAFI I PERIKLIUT

përktheu nga greqishtja
VANGJEL DULE

Për nder, pra, të të rënëve të parë të luftës, u ngarkua që të flasë Perikliu, i biri i Ksanthippus. Dhe kur erdhi çasti i duhur, u largua nga varri dhe shkoi drejt podiumit të lartë, ndërtuar me qëllim që të dëgjohej nga sa më shumë njerëz të mbledhur aty dhe foli pothuajse si më poshtë.

[2.35] “Më të shumtit, që kanë folur nga ky vend deri tani, kanë lëvduar ligjvënësin, i cili traditës së varrimit publik i shtoi ligjërimin e Epitafit, sepse e gjykoi të denjë që të rënëve të luftës t’u bëhet një nderim i tillë gjatë varrimit. Por unë do ta konsideroja të mjaftueshëm që, për burrat që u treguan trima me vepra, me vepra t’u shprehen edhe nderimet, porsì këto që shihni të shoqërojnë edhe tani, këtë ceremoni mortore të organizuar nga qyteti, dhe të mos varet fama e shumë burrave, nga elokuenca e oratorit, apo nga mungesa e saj. Sepse është e vështirë që të flasë dikush në masën e duhur, në situata, në të cilat edhe vetë paraqitja e saktë e së vërtetës, me zor bëhet e besueshme. Sepse edhe ai dëgjues,

që nga përvoja e vet i njih ngjarjet dhe është pozitivisht i prirur, ka mundësi që fjalët e oratorit t'i konsiderojë inferiore, krahasuar me ato që ai njih dhe dëshiron, sikurse edhe ai që nuk i njih mjaftueshëm gjërat, sa herë që dëgjon diçka që kapërcen fuqitë e tij, ka gjasa që nga smira të besojë se bëhet fjalë për teprime. Sepse lëvdatat, që thuhet për të tjerët, janë të pranueshme vetëm në masën që secili mendon se edhe ai vetë është i aftë për arritje të ngjashme apo analoge me ato të të lëvduarve. Çdo gjë që shkon përtej kësaj, nxit menjëherë smirën dhe mosbesimin. Megjithatë, përderisa të parët tanë e gjykuan të drejtë këtë traditë, kam edhe unë për detyrë, duke iu bindur ligjit, të përpiqem t'u përgjigjem sa më shumë të jetë e mundur dëshirës dhe bindjeve të secilit prej dëgjuesve të mi.

[2.36] Fjalën time, së pari, do ta nis nga të parët tanë. Sepse është jo vetëm e drejtë, por njëherësh edhe e denjë në një rast të tillë, si i sotmi, që nderimet, t'iu kushtohen kujtimit të tyre. Sepse, duke jetuar vetë, pandërprerë në këto troje, brez pas brezi, deri në ditët tona, na i trashëguan të lira falë trimërisë së tyre. Dhe nëse ata janë të denjë për lëvdatat tona, aq më tepër janë të denjë etërit tanë. Sepse, përtej atyre që trashëguan, ata

fituan me shumë mund edhe superioritetin tonë të sotëm, të cilin bashkë me to, na e lanë trashëgimi neve që jetojmë sot. Edhe ne, të mbledhur këtu, nga ana tjetër, gjithë sa jemi ende pothuajse në moshë të pjekur, e fuqizuar vetë edhe më tej këtë supremaci në shumë drejtime, dhe qytetin e përgatitëm më se mjaftueshëm me gjithçka, si për luftën edhe për paqen. Megjithatë, nuk do të flas as për bëmat luftarake, përmes të cilave u shënuan arritjet tona të ndryshme, dhe as për aktivitetin, me të cilin ne vetë apo etërit tanë, prapësuar agresionet e armiqve helenë apo barbarë, sepse nuk dua të zgjatem pa fund midis njerëzish që të gjitha këto i njohin. Por, së pari, pasi të shpjegoj se cilat parime na frymëzuan që arritëm në lartësinë e sotme dhe se me cilat institucione dhe me çfarë mënyrë jetese prosperiteti ynë u bë kaq i madh, do të vazhdoj me lavdet e të rënëve që kemi përpara, sepse besoj që këto janë edhe të përshtatshme për t'u thënë në këtë rast, por edhe me interes që të dëgjohen me vëmendje nga të pranishmit e shumtë, qytetarë dhe të huaj.

[2.37] Jetojmë realisht në një sistem politik, i cili nuk përpiket që të kopjojë ligjet e të tjerëve, por madje jemi ne që përbëjmë shembull për të tjerët dhe jo imitues të tyre. Dhe sistemi ynë quhet

demokraci, për arsye se qeverisja e shtetit gjendet jo në duart e të paktëve, por në ato të të shumtëve. Nëpërmjet ligjeve, të gjithëve u garantohet barazi drejtësie për interesat e tyre private, ndërsa nga qasja e vlerësimit të përbashkët, çdo qytetar preferohet në funksionet publike jo se i përket një klase të caktuar shoqërore, por nga merita e tij individuale, përderisa dallohet në një fushë të caktuar. Nga ana tjetër, as ai që është i varfër, por që mund t'i ofrojë shërbime qytetit, nuk gjen pengesë për ta bërë atë për shkak të padukshmërisë së tij shoqërore. Sillemi me frymë liberale, jo vetëm në jetën tonë publike, por edhe në komunikimin e përditshëm midis nesh jemi të çliruar nga fryma e dyshimit, sepse nuk indinjohemi ndaj të tjerëve për sa bëjnë për kënaqësinë e tyre, dhe as vrenjtemi në fytyrë në shenjë mospëlqimi; gjest, i cili, në të vërtetë, nuk dëmton, por gjithsesi lëndon. Por ndërsa në marrëdhëniet tona private evitojmë sjelljen e pahijshme, në jetën tonë publike shmangim paligjshmërinë dhe, mbi të gjitha, në respekt të kërkesave të autoriteteve të radhës dhe të ligjeve, në veçanti të atyre që janë sanksionuar për mbrojtjen e të abuzuarve, ose të atyre që, megjithëse të pashkruara, bëjnë me turp të padiskutueshëm shkelësit e tyre.

[2.38] Por për më tepër, u kujdesëm në shumë mënyra edhe për çlodhjen e shpirtit nga mundi. Sepse kemi edhe lojëra dhe tubime të shenjta të sanksionuara gjatë gjithë vitit, edhe shtëpi të hijshme. Dhe kënaqësia e përditshme, që marrim prej tyre, na mban larg nga preokupimet e jetës. Falë madhësisë së qytetit tonë, nga ana tjetër, gjithçka vërshon në të nga të gjitha vendet e botës, dhe në këtë mënyrë ndodh që shijojmë të mirat e prodhuara nga njerëzit e tjerë, sikur të ishin aq tonat, sa edhe prodhimet e vetë vendit tonë.

[2.39] Jemi gjithashtu superiorë ndaj kundërshtarëve tanë edhe nga mënyra e ushtrimit në çështjet luftarake. Së pari, në atë që portat e qytetit tonë i kemi të hapura për të gjithë, dhe kurrë nuk pengojmë duke dëbuar askënd të huaj, për të mos mësuar apo parë diçka, nga frika se mos, nëse nuk e mbajmë të fshehtë, do ta shohë dikush nga armiqtë tanë dhe do të përfitojë. Sepse besimin tonë ne e mbështesim jo në përgatitjet apo truket luftarake, por në trimërinë tonë personale në kohën e aksionit. Mandej, në lidhje me kalitjen, ata, me ushtrim të mundimshëm që në fëmijëri përpiqen të bëhen burrërorë, ndërsa ne, megjithëse ndjekim mënyrë jetese të pasforcuar, jemi po aq të aftë të guxojmë duke u përballur me armiq po aq

të fuqishëm. Dëshmi e kësaj është fakti se, ndërsa Lakedemonët mësyjnë kundër trojeve tona, jo të vetëm, por së bashku me të gjithë aleatët e tyre, ne mësyjmë kundër të tjerëve të vetëm, dhe megjithëse luftojmë në dhé të huaj, kundër njerëzve që mbrojnë vatrat e tyre, si rregull i mundim pa vështirësi. I shtoni kësaj edhe faktin se askush prej armiqve tanë nuk u përball deri sot me forcat tona të bashkuara, sepse në të njëjtën kohë, nuk kujdesemi vetëm për flotën tonë, por edhe në stere, dërgojmë në shumë ekspedita ushtarë prej qytetarëve tanë. Kur, megjithatë, armiqtë tanë përplasen kudo qoftë me një pjesë të forcave tona dhe nëse fitojnë, mburren se na fituan të gjithë, ndërsa nëse munden, se u mundën prej neve të gjithëve së bashku. Kësisoj, përderisa preferojmë t'u bëjmë ballë rreziqeve, duke i marrë madje me lehtësi, e jo duke u ushtruar dhimbshëm, por edhe me burrëri të përfutur jo nga detyrimi ligjor, por nga mënyra jonë e jetesës, kemi avantazhin që, pa u ankuar para kohe për hir të rreziqeve të ardhshme, nëse ndeshemi me to, të tregohemi po aq trima sa edhe kundërshtarët tanë, të cilët i nënshtrohen mundimit të vazhdueshëm. Prandaj qyteti ynë është i denjë për admirim, si për këtë, ashtu edhe për nga shumë aspekte të tjera.

[2.40] Sepse jemi dashurues të së bukurës, por edhe njëherësh miq të thjeshtësisë, edhe kultivojmë intelektin tonë pa sakrifikuar burrimin tonë. Pasuria, nga ana tjetër, na shërben madje si mundësi për të kryer vepra, se sa si motiv për t'u mburrur. As e konsiderojmë turp pohimin e varfërisë, por turpi më i madh është që dikush të mos bëjë çdo përpjekje për të dalë nga varfëria. Në qytetin tonë, për më tepër, ata që kujdesen për çështjet e tyre personale nuk neglizhojnë për këtë arsye ato publike, dhe megjithëse disa janë të angazhuar në njërin, të tjerë në tjetrin profesion, të gjithë zotërojnë mjaftueshëm çështjet politike. Sepse vetëm ne, e konsiderojmë atë që nuk merr pjesë në çështjet publike, jo si dikë që shikon punën e vet, por si qytetar të padobishëm; dhe nëse nuk e ndërmarrim vetë iniciativën e vendimeve të marra, të paktën gjujmë drejt rreth masave që të tjerët propozojnë, sepse besojmë që veprat nuk i dëmton debati, por fakti që dikush nuk sqarohet paraprakisht, përpara se të vijë ora e veprimit përmes debatit. Sepse edhe në këtë, me të vërtetë, dallohem nga të tjerët, ngaqë jemi jashtëzakonisht të guximshëm në veprim dhe njëherësh vetë i studiojmë vetë në thellësi ato që do të ndërmarrim; ndërsa te të tjerët, përkundrazi, padija lind guxim të pamatur, ndërsa reflektimi, hezitim. Për më